



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE
DREJTORIA EKONOMIKE
SEKTORI I NDIHMES EKONOMIKE DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 6049 prot.

B.Curri, më 11/12 / 2025

P.VENDIM

PËR

MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN

“PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË OBJEKTEVE DHE BANESAVE”

Në zbatim të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1 shkronja “b”, nenit 24, 54 shkronja “k”, nenit 55 pika 2 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; nenit 2 pika 45, nenit 3, 15,16 ,neni 40 pika2,nenet 41,2,43, të Ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”,i ndryshuar ,sipas ligjit nr 48/2023. V.K.M-së 384 dt 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore” Si dhe urdherit Nr 208 date 20/10/2025 të ngritur nga Kryetari i Bashkise për krijimin e komisionit per te ndjekur kete program strehimi ,pas diskutimeve vendosi ti propozojë Këshillit Bashkiak Tropoje të;

MIRATOJE;

1. Të miratojë Tabelen e sistemit të pikëzimit për programin e Permiresimit te kushteve te objekteve dhe Banesave si më poshtë:

TABELA E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN “PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË OBJEKTEVE DHE BANESAVE”

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikë
1.1	Kushtet e strehimit	30
A	Disponojne banese me çertifikate pronesia ose ne proçes legalizimi	10
B	Banojnë në banesa rrezik shembjeje	10
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	2
Ç	Kanë mbetur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha si rezultat i fatkeqësive natyrore ose i zbatimit të një vendimi gjyqësor	8
1.2	Kushtet familjare	20
A	Familjet e policëve të rënë në detyrë	5

B	Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore	5
C	Familjet me më shumë se 4 fëmijë ose familje njëprindërore	5
Ç	Familje të minoriteteve Rome dhe Egjiptiane	5
1.3	Kushtet sociale	20
A	Persona me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave	10
B	Individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç	4
C	Emigrant i rikthyer, punëtor emigrant	2
Ç	Viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit	4
1.4	Kushtet ekonomike	30
A	Të ardhura nën 80% të të ardhurave mesatare	15
B	Të ardhura deri 80% - 100% të të ardhurave mesatare	10
C	Të ardhura 100% - 120% të të ardhurave mesatare	5

Shënim

Pikët maksimale që mund të përfitojë një familje janë 100. Nuk mund të mbledhen brendapërbrenda një kriteri pikët:

1. Nga A deri në Ç të kriterit 1.1;
2. Nga A deri në Ç të kriterit 1.2; dhe
3. Nga A deri në C të kriterit 1.4.

Pikët nga A deri në Ç të kriterit 1.3 mund të mbledhen me njëra-tjetrën sipas rasteve më poshtë:

1. Pika A mund të mbledhet me njërin prej rasteve si më poshtë:

a) Me pikat B dhe Ç së bashku ose veçmas;

b) Vetëm me pikën C;

2. Pika B mund të mbledhet vetëm me pikën A.

3. Pika C mund të mbledhet vetëm me pikën A.

4. Pika Ç mund të mbledhet me pikat A e B së bashku ose me njërin prej tyre.

Në total mbledhja e pikëve A, B e Ç nuk duhet të rezultojë më e lartë se 20 pikë.

2. Ngarkohet Komisioni i Strehimit Bashkiak Tropoje, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi (dhjetë) ditë pas mbledhjes

Konceptoi: Specialisti i Strehimit
B. Buçpapaj

Pranoi.: P. Sek. Ndekonomike dhe Mbrojtjes Sociale
Sh. Gjoka

Ligjishmeria

KRYETARI
Rexhe BYBERI